

KËRKESË
Nr. 2988, datë 10.9.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “SHPËTIM DAKU”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“SHPËTIM DAKU”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000590-5

Datë 23.8.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe procesverbalin e inspektimit nr.ISHMPUT-TR-2019-000590-2, datë 25.7.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Shpëtim Daku, me NIPT L21331010C, përfaqësues i autorizuar i subjektit Shpëtim Daku (Administrator), prej datës 25.7.2019, ora 15:00 deri më datën 25.7.2019, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datën 25.7.2019 dhe e njoftoi më datën 25.7.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, neni 29, pika 1/a/ii.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit," të ndryshuar, datë 14.7.2011, neni 29, pika 1/a/ii, Subjekti ushtron aktivitetin e demontimit të makinave në fund të jetës, i papajisur me leje mjedisore përkatëse. Zhvillimi i veprimtarisë që është subjekt i një lejeje mjedisi tipi B pa lejen përkatëse të mjedisit, dënohet me masë administrative gjobë. Ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 500 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim të aktivitetit deri në pajisjen me lejen mjedisore përkatëse.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Genci Hicka ID: 0301020016

Ilir Nishani ID: 0301020022

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti Shpëtim Daku ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.